



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori e thelluar

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• ***Pyetjet me zgjedhje***

Numri i pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	B	A	C	A	A	C	B	D	C

• ***Pyetjet me zhvillim***

Pyetja 11 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- Duke qenë se me përhapjen e reformatcionit, pozitat e kishës katolike u tronditën fort, Papati mendoi të mbledhte një koncil për të forcuar pozitat e kishës (për të rifituar besimtarët e humbur).
- Vetëm kisha mund të bënte shpjegimin dhe interpretimin e Biblës.
Shërbimet fetare të kryheshin në latinisht.
Priftërinjtë nuk mund të martoheshin.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse përcakton qëllimin e koncilit dhe dy nga vendimet;

OSE

2 pikë Nëse përcakton qëllimin e koncilit dhe një nga vendimet;

1 pikë Nëse përcakton qëllimin e koncilit OSE një nga vendimet;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **3 pikë****Model pergjigjeje**

Pa pëlqimin dhe miratimin e parlamentit, mbreti:

- nuk mund të hartonte ose të shfuqizonte ligje.
- nuk mund të vendoste taksa.
- nuk mund të rriste numrin e ushtrisë në kohë paqeje.
- nuk mund të ndërhynte në diskutimet e anëtarëve të parlamentit.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tri nga vendimet e mësipërme;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga vendimet e mësipërme;

1 pikë Nëse shkruan një nga vendimet e mësipërme;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Perandoria Bizantine ruajti dhe trashëgoi thesaret kulturore të Greqisë dhe Romës antike duke iu përshatur realitetit të epokës mesjetare. Bizantët ruajtën në mënyrë të veçantë veprat e letërsisë, të filozofisë e të historianëve e gjeografëve greko-romakë.
- b) Afërsia e Bizantit me vendet e qytetëruara të lindjes (Siri, Persi, Egjipt) kushtëzoi një ndërthurje të përbërësve më të mirë të kulturës antike greko-romake me atë të vendeve të lindjes. Nga persët u huazua në arkitekturë forma e kupolës në ndërtimin e manastireve e të kishave, nga shkollat e Antiokisë e Aleksandrisë në Bizant depërtuan ideologji të ndryshme.
- c) Roli i shkollës së Kostandinopojës e krijuar në shekullin e V, ku krahas njerëzve të ditur të këtij qyteti jepnin mësim dijetar nga Athina e Aleksandria. Në shekullin e IX u kthye në një universitet të vërtetë ku studioheshin jo vetëm idetë fetare, por edhe filozofi, histori, gramatikë, matematikë, astronomi, fizikë, gjeografi.
- d) Dijetarët bizantinë i kushtonin gjithashtu vëmendje studimit të natyrës. Përparim shënoi matematika, astronomia dhe mjekësia. Për zhvillimin e këtyre dijeve bizantinët u mbështetën te veprat e autorëve antikë.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shpjegon tre nga faktorët e mësipërm;

OSE

2 pikë Nëse shpjegon dy nga faktorët e mësipërm;

1 pikë Nëse shpjegon një nga faktorët e mësipërm;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) U rrit numri i banorëve në qytete;
- b) Pati ndryshime në raportin midis lindshmërisë dhe vdekshmërisë, ku u rrit vdekshmëria foshnjore;
- c) Strehimi i pamjaftueshëm;
- d) Kushtet higjieno–sanitare të këqija;
- e) Mungonin shërbimet komunale, sidomos furnizimi me ujë të rrjedhshëm.

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse liston dy nga tiparet e mësipërme;

OSE

1 pikë Nëse liston një nga tiparet e mësipërme;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **3 pikë**
Model përgjigjeje

- a) Efektshmëria e qeverisjes në perandori varej nga cilësitë personale të perandorit, aftësia e përkushtimi i tij në realizimin e interesave mbarëkombëtare e mbarëshoqërore. Me ardhjen në fuqi të Aurangzebit në vitin 1658 gjendja politike në Perandorinë Indiane u vështirësua shumë. Qeverisja ishte e paefektshme sepse oborri perandorak ishte përfshirë në jetë ekstravagante me shpenzime marramendëse për sende luksi
- b) Perandoria Indiane përfshinte shumë territore me popullsi të ndryshme kombëtare e fetare, ekuilibri midis qeverisjes qendrore dhe atyre të provincave apo rajoneve mungonte.
- c) Mungonte harmonia dhe toleranca midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.
- d) U ndalua praktikimi i besimit indus.
- e) U vendosën taksa të posaçme për jomyslymanët,
- f) Fisnikët indianë u privuan nga të drejtat e tyre. Në këto rrethana në Perandorinë Indiane u përhap anarkia e shpërthyer rebelime, që çuan në dobësimin e saj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse liston tre nga faktorët e mësipërm;
OSE
2 pikë Nëse liston dy nga faktorët e mësipërm;
1 pikë Nëse liston një nga faktorët e mësipërm;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **3 pikë**
Model përgjigjeje

- a) Roli i veçantë i shtetit, i cili ndërtoi “ndërmarrjet model” që më pas iu shitën me çmime të ulta firmave private.
- b) Zbatimi i teknologjisë moderne e cila rriti së tepërmi prodhimin. Japonezët përvetësuan arritjet më progresive të kohës.
- c) Shkalla e lartë e kursimeve, gjë që i siguroi bankave fonde të bollshme për ofrimin e kredive në investimet e kapitalit privat.
- d) Shkalla e arsimimit të popullsisë ishte e lartë, 40% e japonezve ishin të arsimuar, treguesi më i lartë në Azi. Shumë japonezë u arsimuan jashtë vendit.
- e) Në zhvillimin e shpejtë të vendit ndikoi dhe paga relativisht e vogël e fuqisë punëtore.
- f) Ndjenja e krenarisë kombëtare për ta bërë Japoninë një nga vendet më të zhvilluara në ekonomi dhe ushtri.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shpjegon tre nga faktorët;
OSE
2 pikë Nëse shpjegon dy nga faktorët;
1 pikë Nëse shpjegon një nga faktorët;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Globalizimi shpreh unitetin e botës me ndërvarësinë midis qytetërimeve.
- Asnjë nga qytetërimet nuk mund të zhvillohet i izoluar, pa shkëmbime e përfitime të ndërsjella.
- Lidhjet e gjithanshme ndërrajonale e botërore kanë çënuar kufijtë ndërmjet ekonomive e tregjeve të vecanta, që janë kusht i domosdoshëm për politikën ekonomike kombëtare.
- Qeveritë e kanë të vështirë të menaxhojnë ekonominë jashtë ndikimit të faktorëve globalë.
- Ndikimi global krijoi probleme edhe për shtetin e mirëqënies sociale, i cili ka qenë i organizuar mbi baza krejtësisht kombëtare.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse argumenton sa më sipër;**OSE****2 pikë** Nëse liston dy nga ndikimet;**1 pikë** Nëse liston një nga ndikimet;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 18****3 pikë****Model përgjigjeje**

- Kriza e superprodimit. Rritja e prodimit nuk eci në përpjestim të drejtë me fuqinë blerëse të konsumatorëve kjo çoi në mbiprodhim dhe shumë prodhime mbeteshin stoqe të pashitura.
- Shpërndarja e pabarabartë e pasurisë e cila ndikoi negativisht në nivelin e konsumit.
- U rrit shumë numri i kredive të pakthyera gjë që solli falimentimin e shumë bankave.
- Mos kryerja siç duhet e rolit rregullues dhe kontrollues të shtetit në ekonomi.
- Ligjet ndaluese shkaktuan zhvillimin e aktiviteteve kontrabandiste.
- Rënia e Bursës së Neë-Jorkut. Spekulumet në Bursën e Neë-Jorkut tronditën sistemin financiar nëpërmjet rritjes artificiale të vlerës së aksioneve.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse liston tre nga shkaqet e krizës;**2 pikë** Nëse identifikon dy nga shkaqet e krizës;**OSE****1 pikë** Nëse identifikon një nga shkaqet e krizës;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 19****3 pikë****Model përgjigjeje**

- Për shkak të konsiderimit të qeverisë së Vlorës si një qeveri lokale nga Fuqitë e Mëdha.
- Veprimtaria e dy pushteteve të tjera në vend: Komisionit Ndërkombëtar në Shkodër dhe “Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme” pënguan veprimtarinë kombëtare të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës”
- Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit nuk e njohu qeverinë e Vlorës.
- Për shkak të zgjedhjes së një princi të huaj që së shpejti do të mbërrinte në Shqipëri, qeveria e të cilit do të njihej nga Fuqitë e Mëdha.
- Për shkak të mosrealizimit të objektivave që i vuri vetes në programin e saj si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm.
- Për shkak të mungesës së fondeve.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse jep tri nga të mësipërmet;
OSE
2 pikë Nëse jep dy nga të mësipërmet;
1 pikë Nëse jep një nga të mësipërmet;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 20 **4 pikë**
Model përgjigjeje

- a) Pasojat e rolit dominant të fituar prej BS
- Në gjithë vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore, pas Luftës së Dytë Botërore u vendosën regjime komuniste si dhe u krijua kampi socialist.
 - Lufta e Ftohtë si kundërvënie midis dy blloqeve e manifestuar në fushat politike, ekonomike dhe ushtarake.
- b)
- Ndërtimi i Murit të Berlinit, në vitin 1961, e ndau Gjermaninë në dy shtete dhe kryeqytetin me dy sisteme të ndryshme politiko-shoqërore .
 - Kriza e Kubës. Në vitin 1962 BRSS-ja vendosi në ishullin e Kubës baza ushtarake nukleare. SHBA veproi duke vendosur përreth Kubës një bllok me anije, gati për t'i sulmuar anijet luftarake sovjetike.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në katër nga pikat e mësipërme
OSE
3 pikë Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në tre nga pikat e mësipërme
2 pikë Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në dy nga pikat e mësipërme
1 pikë Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në një nga pikat e mësipërme
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-